



VENDIM

Nr.46, Datë 31.03.2017

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË
“C.G.C” SH.P.K. NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË GAZIT
NATYROR**

Në mbështetje të nenit 4 pikat 50, 105, 107; nenit 22 pika 2 gërma “ç”; nenit 83 pika 1 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”; neneve 4, pika 1, gërma “ç”; neni 8 dhe 9 pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 2, gërma “e” dhe nenin 10, pika 1 nenin 11 të “Rregullave dhe Procedurave për Liçensimin, Ndryshimin, Transferimin e Pjessbëm ose të Plotë, Heqjen ose Rinovimin e Liçensave në sektorin e Gazit Natyror” të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr.9, datë 11.02.2011, nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullave për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE”, miratuar me vendimin nr.96, datë 17.06.2016Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 31.03.2017, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “C.G.C” SH.P.K, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut për liçensimin në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror të shoqërisë “C.G.C” sh.p.k.

Konstatohet se:

- Formati dhe Dokumentacioni për Aplikim (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”), janë plotësuar në mënyre korrekte;
- Dokumentacioni Ligjor, Administrativ dhe Pronësor, (neni 9, pika 1, gërma “d”/i, d/ii, është plotësuar në mënyre korrekte;
- Gërmat: d/iv, d/v, d/vi(idenditetin e personave qe kanë interes pronësor më të madh dhe të barabartë se 5%, dokumentat që tregojne titujt e pronësisë, lejet dhe autorizimet mjedisore), janë të pa plotësuar;

- Dokumentacioni dhe Garancitë Financiare dhe Fiskale (neni 9, pika 1, gërma e/i, e/ii, e/v, e/vi(vertetim nga drejtoria e tatimeve, bilancet financiare, pagesa e aplikimit në ERE, plani i biznesit), janë plotësuar;
- Gërma: e/vii(garanci e preformancës) nuk ka informacion.
- Dokumentacioni specifik për llojin e licensës (neni 9, pika 2, gërma e/i, e/ii, sasia e gazit në Nm³ dhe garancia e cilesisë gazit), është e pa plotësuar
- Dokumentet specifike për llojin e licensës (Neni 9 pika 2 gërma e/iii garancia financiare), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mangësitë e konstatuara referuar: neni 9, pika 1, gërma d/iv, d/v, d/vi; neni 9, pika 1 gërma e/vii; neni 9, pika 2, gërma e/i, e/ii, do të njoftohet subjekti në bazë të nenit 10 pika 1 të *“Rregullave dhe Procedurave për Liçensimin, Ndryshimin, Transferimin e Pjesëm ose të Plotë, Heqjen dhe Rinovimin e Liçensave në sektorin e Gazit Natyror”*

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për liçensimin e shoqërisë “C.G.C” SH.P.K. në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit AHMETI